REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 617/ 10 prot. Datë 08.06.2023

V E N D I M
Nr. 483/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.06.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "*Adel Co"* SHPK në procedurën e prokurimit "*Procedurë e Hapur"* me Nr. REF-*43518-09-27-2022*, me objekt "*Prodhimi i emisioneve të Pullës për vitin 2022"*, me fond limit 20,544,080 (*njëzet milion e pesëqind e dyzet e katër mijë e tetëdhjetë*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 21.02.2023 nga autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SH.A.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "*Kristalina - KH"* SHPK dhe "*Albdesign PSP*" SHPK në procedurën e prokurimit "*Procedurë e Hapur"* me Nr. REF-*43518-09-27-2022*, me objekt "*Prodhimi i emisioneve të Pullës për vitin 2022"*, me fond limit 20,544,080 (*njëzet milion e pesëqind e dyzet e katër mijë e tetëdhjetë*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 21.02.2023 nga autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SH.A.

Ankimues: Operatori Ekonomik "*Kristalina - KH*" SHPK
Adresa: Rruga "Lord Bajroni", Laprak, Tiranë.

	Operatori ekonomik "*Adel Co"* SHPK Adresa: Rruga "Muhamet Gjollesha", Zogu i Zi, Tiranë.
Autoriteti Kontraktor:	Posta Shqiptare SH.A. Adresa: Rruga "Reshit Çollaku", Nr. 4 Tiranë.
Baza Ligjore:	Ligji nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik*", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*".

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.09.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit "*Procedurë e Hapur"* me Nr. *REF-43518-09-27-2022,* me objekt *"Prodhimi i emisioneve të Pullës për vitin 2022",* me fond limit 20,544,080 *(njëzet milion e pesëqind e dyzet e katër mijë e tetëdhjetë)* lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 21.02.2023 nga autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SH.A..

II.2. Në datën 21.02.2023 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Në datën 06.03.2023 autoriteti kontraktor me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.) në rubrikën kërkesa ka njoftuar operatorin ekonomik "*Adel Co*" SHPK me objekt "Kërkesë për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët".

II.4. Në datën 08.03.2023 operatori ekonomik "Adel Co" SHPK me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.) në rubrikën kërkesa ka paraqitur argumentimin për ofertën anomalisht të ulët sipas kërkesës së bërë nga autoriteti kontraktor në datën 06.03.2023.

II.5 Në datën 10.03.2023 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.	"Adel Co" SHPK	12,648,350	lekë	kualifikuar
2.	"Kristalina - KH" SHPK	15,408,000	lekë	kualifikuar
3.	"Albdesign PSP" SHPK	19,270,050	lekë	kualifikuar

II.6. Në datën 15.03.2023 autoriteti kontraktor me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.) në rubrikën kërkesa ka njoftuar operatorin ekonomik "*Adel Co*" SHPK me shkresën si më poshtë vijon:

Përshëndetje,
Bazuar në nenin 26 pika 6, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" ndryshuar me pikën 1/b të VKM-së Nr. 710, datë 24.11.2021, ku parashikohet se: Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j", të pikës 2, të këtij neni si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike".
Si dhe në zbatim të udhëzimit nr. 7, te APP-se date 30.07.2021 "Per menyren e zhvillimit te procedures se prokurimit me mjete elektronike" (e ndryshuar), faqe 70 citohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I

dërgon operatorit ekonomik fitues me anë të opsionit "Kërkesa", nga llogaria e anëtarit të KVO, kërkesën me përmbajtjen si më poshtë:

Duke iu referuar procedures me objekt ***"Prodhimi i emisioneve të Pullës për vitin 2022"****, informojmë "Adel CO" sh.p.k me NUIS L22117021M me vlerë të ofertës ekonomike 12,648,350lekë pa TVSH, është kualifikuar i pari.*

Sa me siper, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor "Posta Shqiptare" sh.a., Adr.: Rr. "Reshit Çollaku", Nr. 4, Tiranë, dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j", të pikës 2, të këtij neni si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike", brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon dokumentacionin e dorëzuar e deklaruar në ofertë brenda afatit përfundimtar ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, procedura do të anullohet, siç parashikohet në nenin 98 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

II.7. Referuar shkresës nr. 2127/48 prot, datë 18.05.2023 protokolluar me tonën me nr. 617/8 prot datë 18.05.2023, autoriteti kontraktor ka vënë në dispozicion të Komisionit të Prokurimit Publik informacionin dhe dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik në zbatim të kërkesës së autoritetit kontraktor të datës 15.03.2023 për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.8. Në datën 20.03.2023 është Publikuar Njoftim Fituesi i procedurës së prokurimit objekt-ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe në buletinin nr. 28 të datës 27.03.2023 të Agjencisë së Prokurimit Publik.

II.9. Në datën 23.03..2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. 617/2023 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/2976 datë 23.03.2023 e operatorit ekonomik "*Kristalina - KH*" SHPK me anë të së cilës kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "*Adel Co*" SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.9.1. Në përputhje me nenin 112 "*Veprimet paraprake*" të Ligjit nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 617/2 prot., datë 24.03.2023 janë publikuar kriteret e kualifikimit për të cilat operatori ekonomik ankimues "*Kristalina KH*" SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik "*Adel Co"* SHPK dhe i kundërshton me anë të ankesës me nr. 617 prot, datë 23.03.2023.

II.9.2. Me shkresën nr. 2127/42 prot, datë 30.03.2023 protokolluar me tonën me nr. 617/4 prot datë 31.03.2023, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues *"Adel Co*" SHPK e cila ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.9.3. Me shkresën nr. 2127/45 prot, datë 04.04.2023 protokolluar me tonën me nr. 617/5 prot datë 05.04.2023, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues *"Kristalina - KH*" SHPK e cila ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.9.4. Me shkresën nr. 2127/46 prot, datë 06.04.2023 protokolluar me tonën me nr. 617/6 prot datë 06.04.2023, autoriteti kontraktor ka vënë në dispozicion të Komisionit të Prokurimit Publik informacionin dhe dokumentacionin dhe mostrat lidhur me procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.9.5. Me shkresen Nr. 617/7 prot., datë 12.05.2022 me objekt "*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhenie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik* "*Kristalina - KH" SHPK*", KPP iu drejtua autoritetit kontraktor, Posta Shqiptare, duke i kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vetëm dokumentacionin në lidhje me vërtetueshmërinë e pretendimeve në lidhje me kriteret e kualifikimit për të cilat operatori ekonomik ankimues "*Kristalina KH*" SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik "*Adel Co"* SHPK pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi, sipas kërkesës së bërë nga ana e autoritetit kontraktor më datë 15.03.2023, në lidhje me vërtetueshmërinë e kritereve të deklaruara në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

II.9.6. Me shkresën nr. 2127/48 prot, datë 18.05.2023 protokolluar me tonën me nr. 617/8 prot datë 18.05.2023, autoriteti kontraktor ka vënë në dispozicion të Komisionit të Prokurimit Publik informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar nëpërmjet shkresës nr. 617/7 prot, datë 12.05.2023 lidhur me procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.10. Në datën 20.03.2023 është Publikuar Njoftim Fituesi i procedurës së prokurimit objekt-ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe në buletinin nr. 28 të datës 27.03.2023 të Agjencisë së Prokurimit Publik.

II.10.1. Në datën 24.03.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. 627 prot e operatorit ekonomik "*Adel Co"* SHPK me anë të së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "*Kristalina – KH*" SHPK dhe "*Albdesign PSP*" SHPK në këtë procedurë prokurimi.

II.10.2. Në përputhje me nenin 112 "*Veprimet paraprake*" të Ligjit nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e

zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 627/2 prot., datë 27.03.2023 janë publikuar kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues "*Adel Co*" SHPK me anë të ankesës me nr. 627 protokolli, datë 24.03.2023, pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë "*Kristalina - KH*" SHPK dhe "*Albdesign PSP*" SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.10.3. Me shkresën nr. 2127/42 prot, datë 30.03.2023 protokolluar me tonën me nr. 627/3 prot datë 31.03.2023, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues *"Adel Co*" SHPK e cila ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.10.4. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se pranë Komisionit Prokurimit Publik është depozituar formulari i paraqitjes së argumenteve nr. 617/3 prot, datë 27.03.2023 nga operatori ekonomik i interesuar "*Adel Co*" SHPK sipas parashikimeve në nenin 113 ligji Nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*".

III
Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, në zbatim të nenit 29 pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik",* në të cilin parashikohet se *"1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre."*, referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës me nr. 617 prot, datë 23.03.2023, paraqitur nga operatori ekonomik "*Kristalina - KH*" SHPK ka lidhje me vendimet dhe veprimet e autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Akoma më tej, referuar nenit 118 pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" të ndryshuar, parashikohet se: "*2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji; b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore; ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji; d) të*

refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik. 3. Pas lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit ose entit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë: a) të deklarojë absolutisht të pavlefshme kontratën e nënshkruar, në përputhje me parashikimet e këtij ligji; b) të urdhërojë autoritetin kontraktor për shkurtimin e kohëzgjatjes së kontratës dhe të kërkojë ndërprerjen e parakohshme të saj; c) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme si rezultat i shkeljes së këtij ligji", Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se:

III.1.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "*Kristalina - KH*" SHPK në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik "*Adel Co*" SHPK me pretendimit se: "*Kemi bindje dhe ngrejmë dyshimi mbi vlefshmërinë dhe akreditimin e kësaj certifikate të këtij OE, ndaj kërkojmë verifikimin e saj pranë institucioneve përkatëse",* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.2. Në shtojcën nr. 7/2 "*Kriteret e Vecanta të Kualifikimit*" në pikën 2.3.5 "*Kapaciteti Teknik*" në dokumentet standarte të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

2.3.5. *Operatori Ekonomik të jetë i pajisur me çertifikatë* ***ISO 14298*** *për menaxhimin e sigurisë së procesit të prodhimit të mallrave me elemente sigurie ose ekuivalente; (Certifikata duhet te jete e leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te cilat jane te akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise).*

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik "*Adel Co"* SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Çertifikatë ISO 14298:2013 lëshuar nga AXE Register me nr. IT19-18303Z Për fushën e veprimtarive "*Përgatitje, shtypje të matërialeve të ndryushme, të produkteve filatelike dhe të produkteve me element sigurie. Printim dixhital dhe zarfim. Prodhim dhe tregtim i materialeve plastike, prokateve dhe materialeve metalike me elemente sigurie. Botime e shtypje e faturave të ndryshme*", lëshuar në datën 25.07.2019 dhe me skadencë në datën 24.07.2025;

III.1.4. Në nenin 2 "*Qëllimi i ligjit*" 162/2021 "*Për prokurimin publik*" parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit*

publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.5. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: *"1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat* e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.6. Në nenin Neni 77 të ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
c) aftësinë teknike dhe profesionale.
Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.
2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.
Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.
3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.
Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe pasivit.
Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.
Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.
4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.
Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.
Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.
5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;

b) efiçencës së energjisë;

c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.1.7. Në nenin Neni 92 te ligjit Nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:
1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet

asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.
2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.
3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.
Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.1.8. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:
a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose
b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose
c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike

III.1.9. Në nenin 1 "*Qëllimi*" e ligjit Nr. 116 datë 11.09.2014 "*Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë*", parashikohet:

Ky ligj përcakton rregulla për krijimin, organizimin dhe funksionimin e sistemit të akreditimit të organeve të vlerësimit të konformitetit që kryejnë aktivitete të vlerësimit të konformitetit.

III.1.10. Në nenin 2 "*Fusha e zbatimit"* e ligjit Nr. 116 datë 11.09.2014 "*Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë*", parashikohet:

Ky ligj zbatohet në çdo rast akreditimi, pavarësisht nëse organi i vlerësimit të konformitetit kryen aktivitet të vlerësimit të konformitetit në fushën vullnetare apo të detyrueshme dhe pavarësisht nëse vlerësimi është i detyrueshëm apo vullnetar.

III.1.11. Në nenin 3 "*Përkufizime"* e ligjit Nr. 116 datë 11.09.2014 "*Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë*", parashikohet:

"Akreditim" është dëshmia/certifikata e lëshuar nga organizmi kombëtar i akreditimit për organin e vlerësimit të konformitetit, që përmbush kërkesat e përcaktuara në standardet e harmonizuara dhe, sipas rastit, çdo kërkesë shtesë, përfshirë ato të vendosura në skemat përkatëse sektoriale, për kryerjen e një veprimtarie specifike të vlerësimit të konformitetit.

"Organizëm kombëtar i akreditimit" është organizmi i vetëm që kryen akreditimin me autoritetin e dhënë nga ligji. 3. "Certifikatë akreditimi" është një dokument ose një tërësi dokumentesh zyrtare, që deklarojnë akreditimin për një fushë të përcaktuar.

"Vlerësim konformiteti" është procesi që provon nëse janë përmbushur kërkesat e specifikuara për një produkt, proces, shërbim, sistem, person ose organ.

"Organ i vlerësimit të konformitetit" është çdo organ që kryen veprimtari të vlerësimit të konformitetit, përfshirë kalibrimin, testimin, certifikimin dhe inspektimin.

III.1.12. Në nenin 5 "*Procesi i Akreditimit"* e ligjit Nr. 116 datë 11.09.2014 "*Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë*", parashikohet:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton:
a) laboratorë testues, mjekësorë dhe kalibrues;
b) organe certifikuese të sistemeve të me- naxhimit;
c) organe certifikuese të personelit;
ç) organe certifikuese të produkteve;
d)organe inspektuese;
dh) organe që realizojnë teste zotësie dhe krahasime ndërlaboratorike;
e) organe që prodhojnë materiale referuese të certifikuara.

III.1.13. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është

e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.14. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

KPP konstaton se, duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, një nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues *"Kristalina - KH*" SHPK ka të bëjë përkatësisht me pretendime për mos përmbushjen nga ana e operatorit ekonomik "*Adel Co*" SHPK të kriterit *në lidhje me çertifikatë* ***ISO 14298*** *për menaxhimin e sigurisë së procesit të prodhimit të mallrave me elemente sigurie ose ekuivalente.*

Në kuadër të shqyrtimit administrative të ankesës, në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se për sqarimin e fakteve kërkohen verifikime të posacme pranë organeve kompetente si Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit si institucioni i vetëm publik i cili në bazë të ligjit nr 116 datë 11.09.2014 "*Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë*" në nenin 4 të tij thuhet se "*Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit është i vetmi organizëm kombëtar që kryen akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit*". Nga verifikimi në ëeb-in http://dpa.gov.al/organe-te-akrediuara/ konkretisht trupës AXE Register por dhe të listës së trupave certifikuese të publikuara rezulton se trupa certifikuese AXE Register nuk është e akrediuar nga DPA për lëshimin e cërtifikatës ISO 14298:201, gjithashtu nga verifikimi rezulton se nuk ekziston asnjë organizëm certifikuese i akrediuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për të lëshuar certifikatën ISO 14298:

2013. Kështu, nga sa më sipër, bazuar në faktet dhe verifikimet e kryera, KPP konstaton se nuk ka organizma certifikues në republikën e Shqipërisë të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për lëshimin e certifikatës ISO 14298:2013 duke bërë kështu të pamundur pajisjen e operatorëve ekonomik me këtë ISO. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në hartimin e kritereve në çdo rast duhet të ketë parasysh elementë të tillë si proporccionaliteti me objektin e kontratës, dobishmëria dhe nevoja që dikton vendosjen e kërkesës. Në rastin konkret KPP vëren kërkesa për disponueshmërinë e ISO 14298:2013 nuk ekziston, pasi nga verifikimi i sipërcituar rezulton se Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nuk ka certifikuar asnjë trupë certifikuese për lëshimin e certifikatës ISO 14298: 2013. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor në vendosjen e këtij kriteri ka ulur rrethin e pjesëmarrësve të cilët nuk kanë një certifikatë ISO të tillë për shkak se vetë institucioni publik i ngarkuar me ligj Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nuk ka akredituar asnjë trupë certifikuese për lëshimin e kësaj certifikate ISO, sikundër konfirmohet dhe nga verifikimet e sipërcituara. Në këtë kuptim autoriteti kontraktor në hartimin e kriterit duhet të kishte pasur parasysh ISO të cilat lëshohen nga trupa të certifikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në përputhje me ligjin 116 datë 11.09.2014 "*Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë*". Gjithashtu, në nenin 79 të ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 *"Për prokurimin publik"*, parashikohet se: "*1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara. 4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit*." Në rastin konkret, KPP gjykon se ndodhet para hartimit të një kriteri i cili përbën diskriminim KPP vlerëson se kriteri i mësipërm ka shkelur një ndër parimet e mësipërme atë të mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, parim i cili është një parakusht *sine qua non* i realizimit të objektit dhe qëllimit të vetë ligjit për prokurimin publik, atë trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit të integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik.

III.1.15. KPP gjykon se kriteret e kualifikimit duhet të jenë të tilla që të vendosin të gjithë pjesëmarrësit në pozita barazie duke u ngarkuar të njëjtat të drejta dhe detyrime. Ndërkohë në rastin konkret autoriteti kontraktor nuk u ka ngarkuar pjesëmarrësve apo personave të interesuar për pjesëmarrje të njëjta të drejta dhe detyrime pasi me kriterin e vendosur ka lënë jashtë pjesëmarrjes një numër shumë të madh ofertuesish të cilët nuk disponojnë ISO 14298:2013 pasi vetë institucioni publik Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e ngarkuar me ligjin nr. 116 datë 11.09.2014 "*Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë*", nuk ka të certifikuar asnjë trupë certifikuese për lëshimin e kësaj ISO-je. Kriteri sa më sipër është diskriminues, ul konkurrencën ndërmjet operatorëve

ekonomikë dhe ka për qëllim krijimin e pengesave për pjesëmarrje në procedurë të operatorëve ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtë për drejtë me kriterin e vendosur. Sa më sipër, KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma "dh", se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar dokumentet e tenderit të mësipërm në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret e kualifikimit nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi.

III.1.16. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma "b" të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", sipas të cilit: *"Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;* nenit 98, pika 1, gërma "d" të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: *"Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj"*, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma "b" të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, ku parashikohet se: *"[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" [...]",* në përfundim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteri kualifikimit në lidhje me kërkesën e ISO 14298:2013, është haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, por dhe me dispozitat e legjislacionit sektorial në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 116 datë 11.09.2014 "*Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë*", ndaj përbëjnë shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues "*Kristalina - KH*" SHPK për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "Adel Co" SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që procedura

e prokurimit objekt ankese do të anulohet, pretendimet te tjera të palës ankimuese, nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "*Adel Co*" SHPK në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik "*Kristalina - KH*" SHPK dhe "*Albdesign PSP*" SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në parashikimin e nenit 110 e vijues të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", si dhe nenit 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon se është e nevojshme të ndalet në elementët e testit të legjitimimit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë *interesi* i ankuesit, *dëmi real ose potencial i pritshëm* dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor *i marrë në kundërshtim me ligjin.*

III.3.1. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.3.2. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës, për sa kohë që Komisioni Prokurimit Publik pasi mori në shqyrtim pretendimet e opëratorit ekonomik ankimues vendosi anulimin e procedurës së prokurimit për shkak të shkeljeve të konstatuara në pikën III. 1.14. Pra, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka se si të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi. Pasi për sa kohë që pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik "*Kristalina - KH*" SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoi se këto të fundit nuk qëndrojnë për shkaqet e cituara në pikën III.1.14 dhe në këtë mënyrë ka vendosur anulimin e procedurës, ndaj dhe përsa kohë procedura e prokurimit objekt shqyrtimi do të anulohet dhe pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues "Adel Co" SHPK kundrejtë operatorit ekonomik "*Kristalina – KH*" SHPK dhe "*Albdesign PSP*" SHPK, nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ, pasi cilido qoftë fati i pretendimeve të tij, për operatorin ekonomik "*Kristalina – KH*" SHPK dhe "*Albdesign PSP*" SHPK pala ankimuese nuk mund të arrijë dot qëllimin e saj final të fitimit të kontratës për shkak të anulimit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi si rrejdhojë e shkeljeve të konstatuara në pikën III.1.14.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë

17.03.2010 *"Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik"*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *"Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "*Kristalina - KH*" SHPK për procedurën e prokurimit "*Procedurë e Hapur"* me Nr. REF-*43518-09-27-2022,* me objekt "*Prodhimi i emisioneve të Pullës për vitin 2022"*, me fond limit 20,544,080 (*njëzet milion e pesëqind e dyzet e katër mijë e tetëdhjetë*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 21.02.2023 nga autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SH.A.

2. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "*Adel Co*" SHPK për procedurën e prokurimit si më sipërcituar.

3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.

4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "*Kristalina - KH*" SHPK.

6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "*Adel Co*" SHPK.

7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	**Anëtar**	**Anëtar**
Fiorent Zguro	**Kreshnik Ternova**	**Anila Malaj**

Kryetar
Jonaid Myzyri

Digitally signed by Jonaid MYZYRI
Date: 2023.06.09 03:45:11

Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date:2023/06/09 15:39:36 +02'00'
62282520230609153927690 20

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Komisioni i Prokurimit Publik)